



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOLEGJI ZGJEDHOR GJYQËSOR
TIRANË

Nr.27 Regj.Them.

Datë Rregj. 05.06.2023

Nr.27 VENDIMI

Datë 07.06.2023

V E N D I M

“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Kolegji Zgjedhor Gjyqësor i mbledhur pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë me trup gjykues të përbërë nga:

Gjyqtare: Alma KOLGJOKA (*Relatore*)

Gjyqtare: Manjola XHAXHO (*Anëtare*)

Gjyqtare: Emona MUÇI (*Anëtare*)

Gjyqtare: Marsela DERVISHI (*Anëtare*)

Gjyqtare: Esmeralda XHILI (*Anëtare*)

me sekretare gjyqësore *Ermelinda Nuraj*, sot më datë 07.06.2023, në seancë gjyqësore me dyer të hapura, mori në shqyrtim çështjen me nr.27 Akti, datë 05.06.2023 që i përket:

PADITËSE:

Partia Aleanca Progresiste LZHK, përfaqësuar nga z. Rizaldo Vrenosi, autorizuar nga Kryetari i Partisë, si përfaqësues i përhershëm i saj pranë KQZ-së, dhe z. Elton Laska, pajisur me Autorizim datë 29.05.2023, lëshuar nga z.Dashamir Shehi, Kryetar i Aleanca Progresiste LZHK.

I PADITUR:

Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve, përfaqësuar nga znj.Ina Osmanaj, pajisur me Autorizimin nr.5838 Prot. datë 06.06.2023.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, përfaqësuar nga znj.Ina Osmanaj, pajisur me Autorizim nr.5838 Prot. datë 06.06.2023.

OBJEKTI:

-Ndryshimin e Vendimit të Komisionit të Ankesave dhe Sanksioneve nr.160 datë 29- 05-2023, për shqyrtimin e kërkesës nr.74 datë 17.05.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve i cili ka vendosur rrëzimin e kërkesës së Komisionerit për subjektin politik Aleanca Progresiste LZHK.

-Kërkojmë detyrimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për të konsideruar të vlefshme kutinë për Këshillin Bashkiak Kurbin, Qendra e Votimit nr.0907 i cili i përket fshatit Shpërdhet, Njësia Administrative Mamurras, Bashkia Kurbin.

BAZA LIGJORE:

Ligji nr.10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative” i ndryshuar; Nenet 23 dhe 23/4, pika 1 dhe 4, të ligjit nr. 8580, datë 17.02.2000 “Për Partitë Politike” i ndryshuar.

Gjykata pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, administroi provat në seancë gjyqësore, dëgjoi pretendimet e fundit të palëve, ku:

Pala paditëse, Partia Aleanca Progresiste LZHK kërkoi:

- Pranimin e padisë sipas objektit.

Pala e paditur, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve kërkoi:

- Rrëzimin e kërkesë padisë si të pabazuar në ligj të paraqitur nga paditësi, "Aleanca Progresiste LZHK". Lënien në fuqi të vendimit nr.160 datë 29.05.2023 të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve.

VËREN:

1. Se pala paditëse, Partia Aleanca Progresiste LZHK i është drejtuar Kolegjit Zgjedhor, duke depozituar pranë Gjykatës Administrative të Apelit, padinë me objekt *“Ndryshimin e Vendimit të Komisionit të Ankesave dhe Sanksioneve nr.160 datë 29.05.2023, për shqyrtimin e kërkesës nr.74 datë 17.05.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve i cili ka vendosur rrëzimin e kërkesës së Komisionerit për subjektin politik Aleanca Progresiste LZHK. Kërkojmë detyrimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për të konsideruar të vlefshme kutinë për Këshillin Bashkiak Kurbin, Qendra e Votimit nr.0907 i cili i përket fshatit Shpërdhet, Njësia Administrative Mamurras, Bashkia Kurbin”*.

1.1 Nga aktet e dosjes rezulton se më datë 05.06.2023 pala paditëse ka paraqitur kërkesë padinë pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë brenda afatit ligjor 5-ditor të parashikuar në nenin 152 të Kodit Zgjedhor.

1.2 Kërkesë padia rezultoi fillimisht të mos jetë paraqitur në respektim të plotë të formës dhe të paraqitjes së saj, kritere këto të përcaktuara në nenin 153 të Kodit Zgjedhor. Për pasojë Kolegji Zgjedhor mori vendimin “Për caktimin e seancës gjyqësore dhe lënien afat për plotësimin e të metave të kërkesë padisë”, duke i lënë kohë/afat 24 orë palës paditëse për plotësimin e këtyre të metave. Pala paditëse brenda afatit të caktuar paraqiti padinë më datë 06.06.2023 në formën e kërkuar nga ligji

I. FAKTET E ÇËSHTJES:

2. Pala paditëse/subjekti Partia Aleanca Progresiste LZHK është bashkimi i partisë Lëvizja Për Zhvillim Kombëtar me partinë Bindja Demokratike dhe faktorë

të tjerë të shoqërisë civile, në formën e një bashkëpunim paraelektoral me synimin për të marrë pjesë në zgjedhjet e 14 majit 2023.

2.1 Pala e paditur/Komisioni Qendror i Zgjedhjeve/palë e paditur, ka autoritetin dhe përgjegjësinë e nxjerrjes së akteve nënligjore për rregullat për verifikimin e dokumentacionit të kandidimit të partive politike/koalicioneve zgjedhore/kandidadëve për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore dhe afatet për zbatimin tyre në përputhje me Kodin Zgjedhor.

2.2 Partia politike “Aleanca Progresiste LZHK”, me vendimin nr.173 datë 14.03.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, ndryshuar me vendimin nr.30 datë 21.03.2023 të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve është regjistruar si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.

3. Presidenti i Republikës, me Dekretin nr.13864 datë 24.10.2022, ka caktuar datën 14 maj 2023, si datën e zhvillimit të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore.

4. Në zbatim të parashikimeve të nenit 70 të Kodit Zgjedhor, si dhe të Udhëzimit nr.01 datë 18.01.2023 “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin dhe verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore” të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, partia “Aleanca Progresiste LZHK” ka depozituar në KZAZ-të e Bashkisë Kurbin, dokumentacionin për regjistrimin e listës shumëmbrore të partisë për 31 kandidatët për anëtarë të Këshillit Bashkiak të sipërcituar.

4.1 Në datën 14.05.2023, në 61 bashki në Republikën e Shqipërisë u zhvilluan zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore.

5. Ka rezultuar se pas përfundimit të zgjedhjeve gjatë transportit është dëmtuar një kuti votimi që i përkiste fshatit Shpërdhet, Njësia Administrative Mamurras, Bashkia Kurbin. Dëmtime pati edhe kutia për kandidatët që garonin për pozicionin

e kryetarit të bashkisë Kurbin por, atë kuti KZAZ nr.15 e cilësoi të vlefshme dhe pranoi që ta numëronte. Për pasojë nga 74 kuti votimi u numëruan vetëm 73, ndërsa kutia objekt ankimi u dërgua në KQZ, pa u hapur për t`u numëruar.

5.1 Gjatë procesit të numërimit të votave, KZAZ nr.15, Bashkia Kurbin, ka miratuar vendimin nr.74 datë 17.05.2023¹, me anën e të cilit ka shpallur si të pavlefshme kutinë e votimit të QV nr.0907 që i përket fshatit Shpërdhet, Njësia Administrative Mamurras, Bashkia Kurbin, me shkakun se kjo kuti ka patur dëmtime.

6. Brenda afatit ligjor, ka paraqitur kërkesë ankimore subjekti zgjedhor "Aleanca Progresiste LZHK", duke kundërshtuar vendimin nr.74 datë 17.05.2023 të KZAZ nr.15, Bashkia Kurbin, si dhe numërimin e votave që gjenden në kutinë e QV nr.0907, që i përket fshatit Shpërdhet, Njësia Administrative Mamurras, Bashkia Kurbin, si të pabazuar në prova.

6.1 Ankuesi në ankim ka pretenduar si të paligjshëm faktin e mospërfshirjes së rezultatit të QV nr.0907 në tabelën e rezultateve për shkak të shpalljes së parregullt të kutisë nga ana e KZAZ, në kundërshtim me procedurat e Kodit Zgjedhor. Ankuesi ka pretenduar se kutia e votimit ka vetëm një krisje dhe nuk është e dëmtuar në atë masë sa të cënojë integritetin e saj.

7. Kërkesa ankimore nr.77 datë 22.05.2023 i është paraqitur KAS-it, i cili vendosi në seancë paraprake pranimin e saj për shqyrtim datë 29.05.2023, me relator z. Koli Bele.

8. Pas shqyrtimit dhe administrimit të provave: Kërkesës ankimore nr.77 datë 22.05.2023; Vendimit nr.74 datë 16.05.2023 të KZAZ nr.15, Bashkia Kurbin për shpalljen e parregullt të kutisë së votimit të QV nr.0907; Librit të Protokollit; Procesverbalet e Konstatimit; Kutisë së votimit të QV nr.0907, me vendimin nr. 160 datë 29.05.2023 “Për shqyrtimin e kërkesës ankimore nr.77 datë 22.05.2023 të

¹ 1. Të miratojë Tabelën Përmbledhëse të Rezultatit për zgjedhjet për këshillin bashkiak Kurbin, bashkëlidhur këtij vendimi me 5 faqe. 2. Tabelat origjinale të rezultatit të çdo QV-je, të plotësuara nga GN-të janë pjesë integrale e këtij vendimi dhe së bashku me Tabelën Përmbledhëse të rezultateve të dërgohen menjëherë në KQZ..

paraqitur nga ‘Aleanca Progresiste LZHK’, Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve, ka vendosur:

1. Rrëzimin e kërkesës ankimore nr.77 datë 22.05.2023, të depozituar nga subjekti zgjedhor “Aleanca Progresiste LZHK”.

2. Lënien në fuqi të vendimit nr.74 datë 16.05.2023 të KZAZ-së nr.15, Kurbin.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

4. Bazuar në pikën 1 të nenit 145 të Kodit Zgjedhor mund të bëhet ankim kundër këtij vendimi në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij, sipas përcaktimit të pikës 2 të nenit 152 të Kodit Zgjedhor.

9. Kundër këtij vendimi, brenda afatit ligjor, pala paditëse Aleanca Progresiste LZHK ka paraqitur pranë Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor padinë objekt gjykimi.

9.1. Pala paditëse Aleanca Progresiste LZHK, në kërkesë-padi dhe gjatë gjykimit, pretendoi se:

- Interesi i ankuesit/paditës është i ligjshëm sepse në atë qendër votimi kanë marrë pjesë mbi 300 votues dhe votat që i nevojiten për të arritur mandatin e dytë janë më pak se 30 vota.
- Në zgjedhjet e datës 14 Maj 2023, subjekti ankues/paditës Aleanca Progresiste LZHK mori pjesë në Bashkinë Kurbin vetëm sa i takon zgjedhjes për këshilltarë bashkie.
- Në përfundim të numërimit të votave për Këshilltarë subjekti mori 977 vota dhe sipas përlogaritjes nga sistemi rezulton vetëm me një mandat dhe diferenca për të përfituar mandatin e dytë është më pak se 30 vota. Pala paditëse ka pretenduar si të paligjshëm faktin e mospërfshirjes së rezultatit të QV nr.0907 në tabelën e rezultateve për shkak të shpalljes së parregullt të kutisë nga ana e KZAZ, në kundërshtim me procedurat e Kodit Zgjedhor, duke pretenduar se kutia e votimit ka vetëm një krisje dhe nuk është e dëmtuar në atë masë sa të cënojë integritetin e saj.
- Përsa më sipër, në fazën e konkluzioneve përfundimtare, nga përfaqësuesi i palës paditëse u kërkua “Pranimi i padisë. Ndryshimi i Vendimit të Komisionit

të Ankesave dhe Sanksioneve nr.160 datë 29- 05-2023 për shqyrtimin e kërkesës nr.74 datë 17.05.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve i cili ka vendosur rrëzimin e kërkesës së Komisionerit për subjektin politik Aleanca Progresiste LZHK. Detyrimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për të konsideruar të vlefshme kutinë për Këshillin Bashkiak Kurbin, Qendra e Votimit nr.0907 i cili i përket fshatit Shpërdhet, Njësia Administrative Mamurras, Bashkia Kurbin”.

10. Pala e paditur, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, nëpërmjet përfaqësueses së tij, gjatë gjykimit prapësoi se:

- KZAZ nr.15, Bashkia Kurbin ka miratuar vendimin nr.15 më datë 17.06.2023, me anën e të cilit ka shpallur si të pavlefshme kutinë e votimit të QV nr.0907 që i përket fshatit Shpërdhet, Njësia Administrative Mamurras, Bashkia Kurbin, me shkakun se kjo kuti ka patur dëmtime. Kundër këtij vendimi ka paraqitur kërkesë ankimore subjekti zgjedhor "Aleanca Progresiste LZHK", përfaqësuar nga z. Fabian Topollari i cili ka kërkuar kundërshtimin e vendimit nr.74 datë 17.05.2023 të KZAZ nr.15, Bashkia Kurbin, si dhe numërimin e votave që gjenden në kutinë e QV nr.0907, që i përket fshatit Shpërdhet, Njësia Administrative Mamurras, Bashkia Kurbin, si të pabazuar në prova.
- Me mbylljen e procesit të votimit, referuar neneve 112, pikës 5 të nenit 115 dhe vijues të Kodit Zgjedhor, KZAZ-ja nr.15, Bashkia Kurbin ka mbajtur në Procesverbalin e Konstatimit shënimin për të dhënat e kutisë së votimit të deklaruar të parregullt, duke specifikuar dëmtimin e saj.
- Në seancën e datës 29.05.2023, KAS administroi si provë kutinë e votimit të QV nr. 0907 për të bërë kqyrjen e saj. Nga kqyrja rezultoi qartësisht se kjo kuti votimi ishte e dëmtuar në një hapësirë të madhe të saj. KAS konstatoi se kutia ishte e çarë në pjesën fundore të anës së majtë në një masë të konsiderueshme.
- KAS vlerëson se nuk ka vend për të pranuar kërkesën e bërë nga pala ankimuese për numërimin e fletëve të votimit që gjenden në kutinë e QV nr. 0907, pasi siç rezultoi nga kqyrja e bërë në seancën publike të shqyrtimit administrativ, kjo kuti është e dëmtuar në atë masë sa të konsiderohet e parregullt, dhe për këtë arsye, votat e gjendura në të, nuk i nënshtrohen

numërimit, duke kërkuar rrëzimin e kërkesë padisë si të pabazuar në ligj të paraqitur nga paditësi, "Aleanca Progresiste LZHK" dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 160, datë 29.05.2023 të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve.

11. Gjykata pasi analizoi dispozitat ligjore, administroi provat shkresore dhe dëgjoi pretendimet e palëve, çmon se padia e palës paditëse Aleanca Progresiste LZHK është e pambështetur në prova dhe në ligj dhe duhet rrëzuar.

Arsyetimi i Kolegjit

12. Kolegji vë në dukje se sipas nenit 115 pika 1 të Kodit Zgjedhor, *pas përfundimit të votimit, KZAZ realizon marrjen në dorëzim nga grupi përkatës të kutive të votimit me fletë votimi dhe të kutive me materialet e votimit.* Sipas pikës 3 të nenit 155 të Kodit Zgjedhor nëse grupi i marrjes në dorëzim të kutive të votimit me fletët e votimit dhe të kutisë me materialet e votimit, konstaton: *a) se mungojnë ose janë këputur një ose më shumë vula me kode sigurie; b) vendosjen e vulave me kode sigurie është bërë në mënyrë të tillë që lejon hapësira midis trupit të kutisë dhe kapakut të saj; c) se kutia ka në trupin ose në kapakun e saj thyerje ose çarje që lejojnë futjen apo nxjerrjen e fletëve të votimit ose materialit tjetër të votimit; ose ç) se kutia është e llojit, formës ose përmasave të ndryshme nga ato të përcaktuara nga KQZ-ja; atëherë grupi i marrjes në dorëzim informon menjëherë për parregullsinë në KZAZ-në dhe i kërkon asaj që kutia të shënohet “KUTI E PARREGULLT”. KZAZ-ja verifikon menjëherë parregullsinë dhe vendos, sipas pikës 4 të këtij neni. Parregullsia e konstatuar shënohet në Procesverbalin e Marrjes në Dorëzim dhe në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KZAZ-së. Ndërkohë pika 4 e nenit 115 të Kodit Zgjedhor parashikon ndër të tjera se *në rastet kur për një qendër votimi, gjatë marrjes në dorëzim të kutive nga grupet e marrjes në dorëzim për kutitë me fletët e votimit, konstatohet parregullsi, për njërën nga kutitë me fletët e votimit, atëherë ajo kuti vlerësohet si “KUTI E PARREGULLT” dhe dërgohet në këndin e kutive të parregullta. Kutitë e votimit të përcaktuara si “KUTI E PARREGULLT” në asnjë rast dhe për asnjë arsye nuk hapen nga KZAZ-ja dhe as nuk i kalojnë Grupit të Numërimit. Ato dërgohen së bashku me kutinë e materialeve të votimit në KQZ për nevoja të hetimit administrativ, sipas nenit 136 dhe nenit 138 pika 4 të këtij Kodi. Ndërkohë neni 138 pika 4 e Kodit Zgjedhor parashikon se: Kur objekt i ankimit janë kutitë e votimit, të konstatuara si “KUTI TË PARREGULLTA” nga KZAZ-ja, sipas nenit 115 të këtij Kodi, KQZ-ja është e detyruar të kryejë hetim administrativ gjatë**

shqyrtimit të ankesës për atë zonë zgjedhore, sipas nenit 124 të këtij Kodi. Hetimi nuk kufizohet vetëm në këqyrjen nga jashtë të kutisë, duke vlerësuar në tërësi faktet dhe rrethanat që kanë çuar në konstatimin e kutisë si “KUTIE PARREGULLT”, por edhe nëse këto parregullsi kanë ndikuar në materialin zgjedhor. Nëse KQZ-ja, kryesisht ose me kërkesë të subjektit zgjedhor, shprehet me vendim se janë kuti të rregullta, KQZ-ja kryen numërimin fillestar të votave në këto kuti. Votimi në qendrat e votimit, kutia/kutitë e të cilave janë konstatuar si “KUTI TË PARREGULLTA”, sipas nenit 115 të këtij Kodi dhe për të cilat nuk është bërë ankim, sipas nenit 124, konsiderohet i pavlefshëm.

13. Në rastin objekt gjykimi sipas procesverbalit përkatës KZAZ nr.15, Bashkia Kurbin, ka miratuar vendimin nr.74 datë 17.05.2023², me anën e të cilit ka shpallur si të pavlefshme kutinë e votimit të QV nr.0907 që i përket fshatit Shpërdhet, Njësia Administrative Mamurras, Bashkia Kurbin, me shkakun se kjo kuti ka patur dëmtime. Kjo kuti e votave nuk është numëruar, pasi është konsideruar e parregullt. Pala paditëse subjekti zgjedhor ka paraqitur ankim në KAS sipas nenit 124 të Kodit Zgjedhor. Në kuptim të nenit 136 KAS ka detyrimin të bëjë hetim administrativ për të verifikuar pretendimet e palës ankuese. Në rastin objekt gjykimi hetimi administrativ është kufizuar në vlerësimin e rrethanave nëse kutia e votimit është apo jo e rregullt. Konkretisht nga hetimi administrativ, KAS administroi si provë kutinë e votimit të QV nr. 0907 për të bërë këqyrjen e saj. Nga këqyrja rezultoi qartësisht se kjo kuti votimi ishte e dëmtuar në një hapësirë të madhe të saj. KAS konstatoi se kutia ishte e çarë në pjesën fundore të anës së majtë në një masë të konsiderueshme. Kjo cënueshmëri e kutisë së votimit është konstatuar me të drejtë nga KAS e tillë, që në kuptim të nenit 155 pika 3 gërma “a” e Kodit Zgjedhor, i sipërcituar, e bën kutinë e votimit të parregullt. Sipas nenit 138 pika 4 e Kodit Zgjedhor, kutia e votimit që është e parregullt nuk numërohet. Sa më sipër hetimi i kryer nga KAS që përveç procesverbalit për dëmtimin e kutisë së votave ka këqyrrur dhe kutinë e votimit është i plotë dhe i pakundërshtueshëm nga pala paditëse.

14. Kolegji Zgjedhor vë në dukje se pretendimi i palës paditëse se hetimi administrativ i KAS nuk është kryer i plotë, sipas nenit 138 pika 4 e Kodit Zgjedhor,

² 1. Të miratojë Tabelën Përmbledhëse të Rezultatit për zgjedhjet për këshillin bashkiak Kurbin, bashkëlidhur këtij vendimi me 5 faqe. 2. Tabelat origjinale të rezultatit të çdo QV-je, të plotësuara nga GN-të janë pjesë integrale e këtij vendimi dhe së bashku me Tabelën Përmbledhëse të rezultateve të dërgohen menjëherë në KQZ..

pasi mospërfshirja e rezultatit të QV nr.0907 në tabelën e rezultateve për shkak të shpalljes së parregullt të kutisë nga ana e KZAZ, në kundërshtim me procedurat e Kodit Zgjedhor, duke pretenduar se kutia e votimit ka vetëm një krisje dhe nuk është e dëmtuar në atë masë sa të cënojë integritetin e saj, nuk është i bazuar. Konkretisht sipas nenit 124 të Kodit Zgjedhor subjektet zgjedhore mund të kundërshtojnë rezultatin (e votimit) në tabelën përmbledhëse të zonës zgjedhore duke kërkuar ndryshimin e tabelës ose/dhe pavlefshmërinë e rezultatit në një apo disa qendra votimi sipas nenit 160 të Kodit Zgjedhor. Pala paditëse kërkon ndryshimin e rezultatit të tabelës përmbledhëse të zonës zgjedhore duke u konsideruar e rregullt kutia e votave të qendrës së votimit nr.0907 kur ajo është e parregullt dhe për pasojë nuk mund të numërohet dhe të ndryshojë rezultati i tabelës përmbledhëse të zonës zgjedhore.

15. Sa më sipër, KZAZ dhe KAS në përputhje me ligjin, kur kanë konstatuar se kutia e qendrës së votimit nr.0907 ka qenë e parregullt nuk kanë numëruar fletët e votimit. Në këto kushte rezultati i tabelës përmbledhëse të rezultatit të zonës zgjedhore nuk mund të ndryshohet duke u numëruar kutia e qendrës së votimit nr. 0907, siç pretendon pala paditëse. Nga ana tjetër pretendimi se numërimi i fletëve të votimit të kësaj qendre do të çonte në ndryshimin e rezultatit të mandatit për këshillat bashkiak, duke përfituar mandatin një kandidat i palës paditëse, ka të bëjë me pretendime për pavlefshmërinë e zgjedhjeve në qendrën e votimit. Kjo vë në diskutim mundësinë e përsëritjes së zgjedhjeve në zonën zgjedhore nr.15 për këshillin bashkiak Bashkia Kurbin sipas nenit 160 pika 1 dhe 161 pika 1 e Kodit Zgjedhor. Kolegji Zgjedhor vlerëson se një pretendim i tillë, për pavlefshmëri të zgjedhjeve dhe përsëritjen e tyre, është i pabazuar në ligj, sa kohë që sipas nenit 161 pika 5 të Kodit Zgjedhor, zgjedhjet për këshillat bashkiak nuk përsëriten.

16. Sa më sipër Kolegji Zgjedhor e gjen padinë të pabazuar në ligj dhe prova dhe si të tillë e rrëzon atë.

PËR KËTO ARSYE

Kolegji Zgjedhor Gjyqësor, bazuar në Ligjin nr.10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i përditësuar:

V E N D O S I :

- Rrëzimin e padisë.
- Shpenzimet gjyqësore siç janë bërë.
- Ky vendim është i formës së prerë dhe ndaj tij nuk lejohet ankim.
- U shpall sot në Tiranë, më datë 07.06.2023.

GJYQTARE
Manjola XHAXHO

GJYQTARE
Esmeralda XHILI

GJYQTARE
Alma KOLGJOKA

GJYQTARE
Emona MUÇI

GJYQTARE
Marsela DERVISHI